

KOMPLEKSITETI I PRONËS SHOQËRORE, TRANSFORMIMI DHE PRIVATIZIMI I SAJ

*Mr. Driton Sylqa, ligj.
dsylqa@gmail.com*

Abstrakt

Njëra ndër sfidat më të rëndësishme të tranzicionit në shoqërinë tonë është edhe transformimi/privatizimi i pronës shoqërore i artikuluar si ndërmarrje shoqërore, respektivisht publike. Për konceptin e pronësisë shoqërore janë shfaqur dilema të shumta dhe janë dhënë mendime të numërta. Sipas dispozitave kushtetuese të viti 1974 e deri në vitin 1989, pronësia shoqërore ishte pronësi e të gjithë shoqërisë dhe askush nuk kishte të drejtë përvetësimi, as bashkësitë shoqërore politike, as organizatat punuese dhe as individë. Kjo pronësi e formuluar kështu në kushtetutë ishte pronësi specifike që dallonte nga pronësia shtetërore dhe shoqërore. Argumentet që flasin në favor të fakti se shteti ishte pronar i pronës shoqërore janë edhe transformimet e pronës shoqërore në pronë shtetërore nga shtetet e dala nga ish-Jugosllavia. Këtë zgjidhje në mënyrë të tërthortë e ka pranuar edhe Republika e Kosovës përmes Kushtetutës dhe Ligjit mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Gjatë dhjetë viteve të fundit, në Kosovë janë shënuar hapa të rëndësishëm drejt krijimit të ekonomisë së tregut dhe institucioneve të qëndrueshme në përputhshmëri me një kornizë ligjore efikase dhe bashkëkohore. Transferimi i pronës shoqërore në pronë private është cilësuar si hap kyç i reformës për ta bërë Kosovën me një ekonomi të pavarur dhe dinamike. Zgjidhja është gjetur në atë se ndërmarrjet shoqërore iu jepën me qira investitorëve privat në kohëzgjatje prej 99 vjetësh.

Fjalët kyçe: prona shoqërore, ndërmarrjet shoqërore, ndërmarrjet publike, transformimi, privatizimi, tranzicioni.

JEL klasifikimi: B10, E20, I18

Hyrje

Me fillimin e privatizimit të pronës shoqërore janë shfaqur shumë dilema rreth definimit të kësaj prone dhe gjetjes së pronarit të vërtetë, si dhe mënyrës së transformimit të kësaj prone në pronë private. Në fillim shumë ekspertë kanë pasur qëndrime të ndryshme se e kujt ishte kjo pronë dhe si duhej të transformohej në pronë private. Shumë prej tyre kishin qëndrimin se kjo pronë duhet trajtuar si pronë shtetërore por kishte edhe të atillë që mendonin se një pjesë e saj ju takon menaxhmentit të ndërmarrjeve dhe ish-pronarëve që iu kishte marrë prona nga regjimi komunist me anë të formave të ndryshme të shpronësimit.

Mos njohja e pronës shoqërore dhe formimit të saj përmes eksproprijimeve, nacionalizimeve, konfiskimeve, si dhe transformimi i saj nga viti 1945 e deri në vitin 1999, mund ta komplikojnë procesin e transformimit (privatizimit) të pronës

shoqërore në pronë private. Në vitin 1989, Serbia e pat suprimuar autonominë e Kosovës dhe shpërbërë tërë sistemin juridik të Kosovës. Legjislacioni i cili i rregullonte marrëdhëniet pronësore deri atëherë ishte shfuqizuar ndërsa Serbia me ligje diskriminuese kishte bërë transformime të pronës shoqërore në Kosovë pa miratimin e organeve legjitime të Kosovës.

Nga viti 1999 e deri më 15 qershor të vitit 2008, kur është hyrë në fuqi Kushtetuta e Republikës së Kosovës, UNMIK-u kishte kompetenca të rezervuara mbi pronën shoqërore dhe përmes Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM), e udhëhoqi procesin e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore. Deri në qershor të vitit 2008, përafërsisht rreth 80% e vlerës së ndërmarrjeve shoqërore në Kosovë është privatizuar. Pas shpalljes së Kosovës shtet sovran dhe të pavarur u themelua Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), duke krijuar kështu një vazhdimësi të punës dhe proceseve të transformimit të pronës.

1. Kuptimi kronologjik i pronës shoqërore

Pronësia shoqërore në ish-Jugosllavi ashtu edhe në Kosovë, nga viti 1945 e deri në vitin 1950 ishte formuar si pronësi socialiste shtetërore përmes reformave agrare, konfiskimeve, nacionalizimeve, eksproprijimeve, duke u marrë pronat pronarëve privat dhe duke e bartur atë në pronësi shtetërore. Deri në vitin 1950 kooperativat bujqësore dhe ndërmarrjet ekonomike konsideroheshin shtetërore dhe menaxhoheshin nga shteti. Ndërsa koncepti i pronësisë ishte pronësi shtetërore (gjithë-popullore). Me nxjerrjen e ligjit për qeverisjen e ndërmarrjeve nga kolektivitet punuese të vitit 1950, ishte një hap i riorganizimit të ndërmarrjeve dhe ndërtimi i sistemit vetëqeverisës dhe prona shtetërore e ndërmarrjeve konsiderohej pronë shoqërore. Kushtetuta e viti 1963 dhe aktet e tjera ligjore përcjellëse e forcuan sistemin e vetëqeverisjes dhe konceptin e pronësisë shoqërore.

Rregullimi kushtetues i vitit 1974 dhe legjislacioni deri në vitin 1989 e zhvilluan më tej konceptin e pronësisë shoqërore. Me nxjerrjen e Kushtetutës së vitit 1974 të RSFJ-së, vendosen themelet e konceptit të pronësisë shoqërore dhe sistemit vetëqeverisës në të gjitha fushat shoqërore. Sipas rregullimit kushtetutës të viti 1974, ekzistonte edhe prona private por vetëm në maksimumin e paraparë me ligj, dhe në krahasim me pronën shoqërore ishte në numër më të vogël. Pronësi shoqërore mund të ishin pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, si: toka, ndërtesa, banesa, pjesë të veçanta të tokës, ndërtesave, dhe banesave.²⁸

Koncepti i pronësisë shoqërore dhe i sistemit vetë-qeverisës u zhvillua deri në vitin 1989, kur Serbia e pat suprimuar autonominë e Kosovës dhe me ligje diskriminuese kishte bërë transformime të pronës shoqërore përmes aplikimit të masave të përkohshme, të mirënjohura si masa të dhunshme. Në vitin 1999, pas luftës në Kosovë dhe çlirimit të saj, Kosova vendoset nën administrimin e ndërkombëtar të UNMIK-ut. Me vendosjen e UNMIK-ut, si legjislacion në fuqi janë pranuar ligjet që ishin në fuqi deri më 22 mars të vitit 1989 kur është suprimuar autonomia e Kosovës. Ligjet e nxjerra nga Serbia pas vitit 1989 janë shpallur të pa

²⁸ Muharremi, 2001, p. 5.

vlefshme në territorin e Kosovës. Përbashimisht janë shpallur si të zbatueshme vetëm ato ligje që nuk kanë qenë diskriminuese, me qëllim të plotësimit të zbrazëtirës juridike.²⁹

1.1. Interpretime të ndryshme të konceptit të pronësisë shoqërore

Sado që ekzistojnë përkufizime të numërta për pronësinë shoqërore, ato janë diverse dhe ndryshojnë nga njëra tjetra. Sipas autorit Jovan Đ: *“pronësia shoqërore nuk është e drejtë pronësore por formë e jo-pronësisë e mënyrës së prodhimit dhe e bazës së marrëdhënieve shoqërore”*. Ai shton se pronësia shoqërore përfaqëson një mënyrë të re të prodhimit dhe ku prona dhe produktet prodhimit nuk mund të jenë objekt i përvetësimit privat dhe as shtetërorë përveç nëse ato janë përdorur për plotësimin e nevojave personale dhe të përgjithshme të njerëzve punonjës.³⁰

Sipas Andria Gams, pronësia shoqërore më tepër nënkupton një kufizim për të gjitha subjektet që kanë të drejta për të disponuar me sendin dhe të drejtat mbi sendet. Këto të drejta duhet të përdoren në mënyrë sensibile që shërben për të mbajtur dhe zhvilluar shoqërinë për gjeneratat e tashme dhe të ardhshme. Gams, më tej thekson se *“pronësia shoqërore nuk ka titullar unik në formë të shtetit si pronësia shtetërore, madje kjo pronësi nuk ka fare titullar edhe nëse shoqëria konsiderohet si titullar, nuk e ka titullarin e trajtësuar juridikisht. Ndërsa në kuptimin pronësoro-juridik të pronësisë shoqërore, titullar janë vetëm organizatat punuese”*. Duke ju referuar bartësve të autorizimeve në pronësinë shoqërore ai është shprehur se: *“pronësinë shoqërore duhet ta konsiderojmë si pronësi të ashtuquajtur të pjesëtueshme”*.³¹

Autori Aliu, është shprehur se: *“pronësia shoqërore ishte një lloj forme e pronësisë kolektive, pronësi sui generis, ku titullar i pronësisë ishte një kolektiv njerëzish, që punonin me mjetet shoqërore për prodhimin dhe fitimin e të mirave të reja”*.³²

Kurse autori Fetahu duke ju referuar Kushtetutës së Jugosllavisë të vitit 1974 thekson se: *“Mënyra e prodhimit dhe mënyrat tjera të punës së bashkuar, prodhimet nga puna e bashkuar dhe të hyrat tjera të realizuara nga puna e bashkuar, mënyrat e përmbushjes së nevojave të përbashkëta, burimet natyrore dhe pasuritë tjera për përdorim të përgjithshëm - të gjitha janë pronë shoqërore. Asnjë person nuk mund të fitoj të drejtën e pronësisë mbi pasuritë e pronës shoqërore”*.³³

1.2 Definimi i ndërmarrjeve shoqërore

Ndërmarrjet shoqërore në formë të organizatave punuese (OPB) kishin kompetenca në shfrytëzimin dhe disponimin e mjeteve në pronësi shoqërore, mirëpo

²⁹ Raporti i OSBE-së, Privatizimi në Kosovë, Maj 2008

³⁰ Jovan Đ, 1965, p. 11, cit nga Grahovac, 2001, p. 28.

³¹ A.Gams, 1978, p. 44, 82.

³² Shih: Aliu, 2006, p. 276.

³³ Fetahu, 2002. p

bashkësia shoqërore politike (komuna ose niveli krahinor) nën kushtet e përcaktuara me ligj mund t'i shpërndanin këshillat e punëtorëve dhe organet tjera të organizatave punuese dhe organizatave vetëqeverisëse. Bashkësitë shoqërore politike kishin edhe kompetenca edhe në ndihmën ekonomike, dhe sanimin e humbjeve të organizatave punuese kur nuk mund t'i përmbushnin detyrimet e tyre.

Ndërmarrjet shoqërore, nuk kishin të drejtë pronësie mbi asetet e pronës shoqërore ndërsa shitja dhe blerja e aseteve të ndërmarrjes konsiderohej vetëm si transfer i të drejtës së shfrytëzimit por nuk kishin të drejtën e tjetërsimit ose të shkatërrimit të atyre aseteve.³⁴

Koncepti, se pronësia shoqërore është më e afërt me pronësinë shtetërore ka gjetur edhe zbatim në praktikë. Shtetet që ishin pjesë e federatës jugosllave të gjitha me ligjet e tyre e kanë shpallur pronësinë shoqërore si pronësi shtetërore. Këtë zgjidhje në mënyrë të tërthortë e ka pranuar edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Në kreun IX, neni 119, pika 9 thuhet:

*“Republika e Kosovës ushtron të drejtën e pronësisë mbi çdo ndërmarrje që ajo kontrollon në pajtim me interesin publik, me qëllim që të maksimizojë vlerën afatgjate të ndërmarrjes”.*³⁵

Në këtë nen të Kushtetutës nuk janë përmendur shprehimisht ndërmarrjet shoqërore, por sipas Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, shteti përmes kësaj Agjencie i kontrollon dhe administron edhe ndërmarrjet shoqërore dhe pronën e tyre. Andaj edhe prona shoqërore është në pronësi të shtetit sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës.³⁶

1.4 Suprimimi i autonomisë

Në fund të viteve '80 dhe në fillim të viteve '90, Jugosllavia i bënte reformat e fundit ekonomike si përpjekjet e fundit për të dalë nga kriza ekonomike që njihen si reformat e Ante Markoviçit. Në këtë kohë filluan urrejtjet nacionale të cilat quan edhe në luftërat në ish-Jugosllavisë dhe përfundimisht edhe shkatërrimin e Jugosllavisë. Kështu, përveç krizës ekonomike Jugosllavia ishte futur edhe në krizë politike.

Në vitin 1989 nën Regjimin e Millosheviqit me dhunë iu suprimua autonomia Kosovës. Ndërsa në vitin 1990 Serbia e miratoi kushtetutën e saj me të cilën e shtriu pushtetin në mënyrë të drejtpërdrejtë në territorin Kosovës duke i suprimuar të gjitha institucionet e saja. Me suprimimin autonomisë së Kosovës u shkatërrua sistemi juridik i Kosovës dhe marrëdhëniet pronësore u rregulluan me ligje të nxjerra nga Institucionet e Republikës së Serbisë.³⁷

Regjimi i atëhershëm vendosi masa të dhunshme në të gjitha institucionet por edhe në ndërmarrje ekonomike. Në raportet pronësore kishte një ndikim të jashtëzakonshëm nxjerrja e Ligjit të Serbisë mbi pasuritë në pronësi të Republikës

³⁴ Muharremi, 2001

³⁵ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 15 qershor 2008, www.kuvendikosoves.org.

³⁶ Ligji nr. 03/1 – 067 për AKP, 15 qershor 2008, www.kuvendikosoves.org.

³⁷ Kushtetuta e Serbisë, Gazeta Zyrtare e RS, nr.1/90, përmes së cilës organet dhe institucionet e Kosovës të dala nga Kushtetuta, 74 u suprimuan, 1990.

së Serbisë. Përmes këtij ligji Serbia në mënyrë arbitrare i ka definuar si pronësi shtetërore të saj të gjitha pasuritë publike dhe shoqërore të Kosovës duke përfshirë edhe ndërmarrjet. Ndërsa me një varg ligjesh tjera ka ndikuar në transformimin e pronës shoqërore. Në shumë ndërmarrje u vendos menaxhmenti i dhunshëm përmes ligjit për riorganizimin e ndërmarrjeve, ndërsa me ligje diskriminuese u bënë transformime pronësore përmes privatizimit me procedura jo-transparente dhe diskriminuese.³⁸

2. Korniza ligjore e Privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore / publike

Konform rezolutës 1244, Rregullorja e UNMIK-ut 2002/12 e ndryshuar me Rregulloren 2005/18 ka të bëjë me themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM). AKM-ja si organ i pavarur me identitet të plotë juridik kishte kompetenca që t'i Administrojë Ndërmarrjet në Pronësi Shoqërore (N.Sh.) dhe Ndërmarrjet Publike (N.P.) të regjistruara ose që veprojnë në territorin e Kosovës, si dhe pasurinë e këtyre ndërmarrjeve në territorin e Kosovës. Agjencia dispononte me një kapital prej 10 milion eurosh. Objektivi kryesor i AKM-së është privatizimi i plotë i N.Sh.-ve në Kosovë.

Transformimin e pronës shoqërore në atë private e ka përqafuar edhe Republika e Kosovës përmes Kushtetutës dhe Ligjit mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit, e cila është themeluar në përputhshmëri me pakon e Ahtisarit dhe në bazë Ligjit të Kuvendit të Kosovës Nr. 03/L-067. AKP, si një organ i pavarur publik i cili i ushtron funksionet dhe përgjegjësitë në mënyrë plotësisht të pavarur, është trashëgimtare e AKM-së cila do të merret me privatizimin dhe likuidimin e ndërmarrjeve shoqërore.³⁹

Rrjedhimisht, administrimi me ndërmarrjet publike tani kalon nën mandatin e Qeverisë së Kosovës, e cila nuk mund të anuloi inkorporimin e këtyre ndërmarrjeve apo thënë ndryshe transformimin e tyre në shoqëri aksionare. Aksionar i vetëm i këtyre ndërmarrjeve tanimë është Republika e Kosovës. Këtu përfshihen edhe ndërmarrje të tilla si KEK-u (Korporata Elektro energjetike e Kosovës), PTK-ja (Post/Telefonia e Kosovës), Hekurudhat e Kosovës, Aeroporti, etj., që mund të klasifikohen edhe si monopole natyrore dhe me siguri se janë të një rëndësie strategjike për zhvillimin e ekonomisë së Kosovës. Prandaj, modalitetet e privatizimit të tyre duhet shqyrtuar me kujdes të veçantë për faktin e rëndësisë strategjike që kanë.⁴⁰

2.1 Privatizimi i pronës shoqërore

Rezultatet nga privatizimi i deritashëm i ndërmarrjeve shoqërore tregojnë se privatizimi ka funksionuar me një dinamikë të theksuar me gjithë të metat e procesit. Në kuadër të procesit të privatizimit në Kosovë, që nga viti 2002 e deri në prill të vitit 2010 janë tenderuar 263 ndërmarrje shoqërore. Prej tyre, 467 tashmë i

³⁸ Tigani & Hysa, 1999

³⁹ Përmbledhje ekzekutive nga “Pako e Ahtisarit”, përkthim në gjuhën shqipe

⁴⁰ Ibid

kanë nënshkruar kontratat e shitblerjes dhe në pritje janë 65. Rrjedhat tjera karakteristike të privatizimit, duke përfshirë edhe të metat e procesit, jepen si më poshtë:

- Deri tani janë privatizuar 545 ndërmarrje të reja, prej të cilave 521 janë privatizuar përmes metodës së "spin off"-it të rregullt, ndërsa 24 prej tyre janë privatizuar përmes metodës së "spin off"-it special;
- Nga privatizimi janë grumbulluar rreth 500 milionë euro. Rreth 100 milion euro nga këto u takojnë punëtorëve, përderisa vetëm 22 milionë u janë shpërndarë punëtorëve. Procesi i shpërndarjes së 20% është cilësuar si tepër i ngadaltë;
- Të hyrat nga privatizimi mbahet jashtë vendit të bllokuara në formë të depozitave. Edhe pse është çuar shumë pluhur për këtë çështje, arsyeshmëria e këtij fakti bazohet në ligjin e likuidimit që thotë se 80% nga të hyrat duhet t'i dedikohet të gjithë kreditorëve të NSh-së që pretendojnë se ndërmarrja në fjalë iu ka mbet borxh;
- Metoda spin-off special është në prag për t'u quajtur e dështuar për shkak të dështimit të pronarëve të rinj për t'i përmbush obligimet e premtuara. Vlerësohet se rreth 196 milionë euro janë premtuar se do të investohen në ndërmarrjet e privatizuara me spin-off special, mirëpo kohëve të fundit është dokumentuar se vetëm një numër i vogël i ndërmarrjeve të privatizuara ka bërë investimet e domosdoshme. Rreth 1000 punëtorë nuk janë punësuar asnjëherë në ndërmarrjet e privatizuara me spin-off special edhe pse ishin premtuar nga pronarët e rinj. Për tetë ndërmarrje, pasi që auditimi ka konstatuar mospërmbushje të zotimeve, aktualisht janë duke u ndërmarrë të gjitha hapat në përputhje me marrëveshjen për zotime dhe strategjinë e monitorimit të ndërmarrjeve;
- Vala e 5-të e privatizimit ka qenë më e suksesshme me rreth 44 milionë euro të hyra nga shitja e ndërmarrjeve të reja. Më e dobëta ka qenë vala e 33-të e privatizimit që solli më pak se 1 milionë euro të ardhura;
- Gjatë procesit të privatizimit në kohën e AKM-së janë privatizuar 21 mijë hektarë tokë bujqësore, ndërsa AKP-ja prej se qeverisë me këtë proces ka privatizuar 2 mijë hektarë. Në proces të privatizimit do të përfshihen edhe 20 mijë hektarë të tjera, kryesisht sipërfaqe me tokë bujqësore;
- Pak investime nga jashtë, vlerësohet se vetëm 9% e investimeve totale vijnë nga jashtë;
- Në maj të vitit 2010, bordi i AKP-së ka aprovuar statusin e 3 "ndërmarrjeve të Gjakovës" si ndërmarrje shoqërore. Rrjedhimisht, këto ndërmarrje do t'i nënshtrohen privatizimit;

Sipas praktikave në rajon, privatizimi zakonisht rezulton me zvogëlimin e vendeve të punës. Pasi që privatizimi dhe transformimi i pronës shoqërore është imperativ për çdo shoqëri në tranzicion, mund të thuhet se procesi i privatizimit në

Kosovë ka pas një tempo dinamike. Në vijim është paraqitur tabela kronologjike lidhur me numrin e ndërmarrjeve nën administrim të AKP-së, sipas regjioneve,

NSH	Gjithsej	Gjilan	Mitrovica	Prishtina	Prizren	Peja
Nr i NSH-ve	600	141	108	155	62	134
Ndërmarrjet Private apo Publike	5	0	2	1	0	2
Ndërmarrjet nën administrim të AKP	595	141	106	154	62	132
Nr.i NSH-ve në Privatizim (nga të cilat):	263	63	27	66	40	67
<i>Në Likuidim</i>	105	28	12	30	17	18
<i>Të privitizuara dhe jo në likuidim</i>	158	35	15	36	23	49
Nr.i NSH-ve në likuidim të shpallura drejtëpërdrejtë	15	6	2	3	3	1
Nr.i NSH-ve ende të pa-privatizuara apo ende të palikuiduara: (nga të cilat)	317	72	77	85	19	64
<i>Trepca – kompleksi i ndërmarrjeve</i>	25	1	20	0	1	3
<i>Administimi direkt</i>	6	1	1	3	0	1
<i>Departmenti i Bujqësisë</i>	26	2	0	19	0	5
<i>Të komercializuara nën UNMIK</i>	11	2	1	5	3	0

ndërmarrjet e privatizuara / në likuidim, etj.

2.2 Metodat e privatizimit

<i>Spin Off special</i>	6	4	0	0	0	2
<i>Nr.i rasteve të asetëve</i>	91	43	7	19	2	20
Nr. i NSH-ve në likuidim	120	34	14	33	20	19
Nr. i NSH-ve në privatizim dhe likuidimi për t'u bërë	158	35	15	36	23	49
Nr. i NSH-ve ende të pa-privatizuara e as të shpallura në likuidim	317	72	77	85	19	64
Numri total i portfolios së NSH-ve	595	141	106	154	62	132
Numri total i likuidimeve për t'u shpallur	475	107	92	121	42	113

Në vijim prezantohen metodat e privatizimit të aplikuara nga agjencia, e që janë: metoda spin-off, spin-off special dhe likuidimi vullnetar.

Spin-off - Metoda e preferuar e AKM-së për të privatizuar N.Sh.-të që kanë afarizëm të qëndrueshëm ishte metoda “Spin-off”, përmes së cilës asetet dhe detyrimet e kufizuara të një N.Sh.-je barten në Ndërmarrjen e Re. “NewCo” i shitet një investitori dhe të hyrat nga shitja janë depozituar deri më tani në një llogari të mirëbesimit, me qëllim të përdorimit të tyre për përmbushjen e obligimeve kreditore dhe pronësore të mbetura të Ndërmarrjeve shoqërore. Më pastaj, N.Sh.-ja do të likuidohet. Ofertuesi me çmimin më të lartë të ofruar është fituesi i përkohshëm i tenderit. Udhëzimet në lidhje me transferimin e pasurive janë bërë kryesisht për të arritur objektivin për maksimizimin e suksesit komercial të Ndërmarrjes së Re. (p.sh. për ta bërë sa më tërheqëse ndërmarrjen për investues). Në disa raste pasuritë nga një NSH e vetme janë ndarë në disa ndërmarrje të reja”.⁴¹

Spin-off Special - Procedurat e Spin-off special janë aplikuar në N.Sh.-të të cilat përmbushin njërin prej kritereve në vijim:

- Më së paku 300 të punësuar (aktiv) ose,
- Të hyrat e përgjithshme prej së paku 10 milion Euro në vit.

Këtu çmimi i ofruar nuk është përcaktuesi kryesor. Për shkak të rëndësisë së veçantë që kanë ndërmarrjet ku aplikohet spin-off special vendosen edhe një mori kushtesh për ofertuesit. Këto kushte ndryshojnë në varësi të natyrës ekonomike të ndërmarrjes gjegjëse.⁴²

Likuidimi Vullnetar - proces i cili udhëhiqet nga Rregullorja 2005/48 mbi riorganizimin dhe likuidimin e ndërmarrjeve dhe pasurisë së tyre me autorizimin administrativ të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit dhe rregullat e likuidimit sipas Rregullores së UNMIK-ut 2001/6 për organizatat e biznesit. Procedura e likuidimit është pothuajse standarde, pra: themelimi i komisionit të likuidimit, lajmërimi i kreditorëve (të njohur me shkrim, të panjohur nëpërmjet mjeteve publike), shitja e asetëve të N.Sh.-së nëpërmjet tenderit, pagesa e kreditorëve, si dhe mjetet financiare të mbetura futen në fondin e mirëbesimit. Likuidimi është procedurë që iu jep mundësinë ndërmarrjeve me biznes të gjymtë që të shuhen dhe të pushojnë së ekzistuari tërësisht. Procedura për likuidimin e NSH-ve mundëson që të ardhurat nga shitja e pasurive të asaj ndërmarrje t'u ndahen në mënyrë të drejtë kreditorëve

⁴¹ Politikat Operacionale të AKM-së, Nëntor 2006

⁴² Ibid

të NSH-ve, në pajtim me prioritetet e themeluara me ligj, dhe çfarëdo teprice eventuale t'u ndahet pronarëve ligjor.⁴³

2.3 Privatizimi i pronës publike

Vitin e kaluar AKP-ja është eliminuar nga procedura e privatizimit të NP-ve, pa marrë parasysh përvojën e saj në privatizimin e ndërmarrjeve të mëdha. Privatizimi i NP-ve është transferuar kështu te Qeveria, duke i dhënë kompetencat të ndjeshme Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave. Ligji mbi NP-të lejon formimin e Komisioneve Qeveritare për Privatizim, përmesës cilave mund të bëhet privatizimi i çdo ndërmarrje publike.

Janë dy mënyra për të transformuar një ndërmarrje publike në pronësi private. E para, një NP mund të kalojë nëpër procesin e privatizimit tradicional, ose më mirë të themi t'u nënshtrohet shitjes së aksioneve të NP-së një subjekti privat. Mirëpo, nga ana tjetër, një NP mund të kalojë në pronësi private përmes një partneriteti publiko-privat dhe/ose dhënies me koncesion për të ndërtuar, përdorur dhe/ose shfrytëzuar infrastrukturën në pronësi publike, si dhe për të ofruar shërbime publike. Këto dy metoda janë adresuar në mënyrë të veçantë, duke u thelluar më shumë në të parën.

Baza ligjore për privatizimin e plotë apo të pjesshëm të një NP-je në Republikën e Kosovës mund të gjendet në Ligjin për Ndërmarrjet Publike ("Ligji për NP"). Domethënë, Ligji për NP-të bën fjalë për "shitje të aksioneve," që mund të interpretohet se ky ligj lejon privatizim të pjesshëm ose të plotë të NP-së në fjalë, varësisht nga vendimi i Qeverisë.

Shitjen e aksioneve e mundëson Ligji mbi Ndërmarrjet Publike, sipas të cilit brenda një kohe të caktuar të gjitha NP-të duhet të organizohet si Shoqërive Aksionare ("SHA"). Sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare, një SHA "është një person juridik që zotërohet nga aksionarët e saj, por që legalisht është i ndarë dhe i veçuar nga aksionarët e saj. "Statusi i SHA sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare është i ngjashëm me statusin e korporatave të cilat mund t'i gjejnë në vendet anëtare të BE-së apo në Shtetet e Bashkuara, me ndryshime të vogla dhe më pak të ndërlikuara. Aksionari i vetëm i një NP-je qendrore është Republika e Kosovës, të drejtat aksionare të së cilës ushtrohen nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Ligji mbi Shoqëritë Tregtare nuk e kufizon transferimin e aksioneve nga Qeveria e Republikës së Kosovës në ndonjë subjekt tjetër.⁴⁴

Një ndër çështjet që duhet të merret parasysh gjatë privatizimit të ndërmarrjeve publike do të ishte vlerësimi i momentit më të përshtatshëm të privatizimit të tyre dhe cila nga ndërmarrjet duhet të privatizohet e para sipas radhës. Sa i përket momentit të privatizimit të ndërmarrjeve publike, për shkak të rrethanave ekzistuese do të duhej të pritej një moment më i volitshëm se ky i tanishmi. Shkaqet përmbledhen në tre pika, si në vijim:

⁴³ Rregullorja e UNMIK 2005/48, 2005

⁴⁴ Riinvest, "Dilema dhe ngecje në rrugën e shpejtë Privatizimi i ndërmarrjeve publike në Kosovë", 2009

- Kriza globale që po rikthehet dhe e cila do të ndikonte drejtpërsëdrejti në uljen e ndjeshme të vlerës së privatizimit dhe Kosova do të merrte qindra miliona Euro më pak;
- Përkeqësimi i klimës së biznesit në Kosovë. Shumë institucione relevante ndërkombëtare përfshirë këtu edhe Bankën Botërore kanë konstatuar se klima e biznesit në Kosovë është përkeqësuar dhe ju kanë bërë apel investitorëve të huaj që mos të investojnë në Kosovë. Edhe kjo do të ndikonte në uljen e vlerës së tregut të ndërmarrjeve publike;
- Performancë e dobësuar e ndërmarrjeve publike;

Çështje tjetër për t'u marrë në konsideratë nga qeveria është çështja e kërkesave të porealizuara të ndërmarrjeve publike që kanë ndaj konsumatorëve të papërgjegjshëm. Dihet se këto kërkesa janë mbi 300 milion euro. Pasi që këto mjete në një mënyrë janë të taksapaguesve kosovarë, realizimi i tyre do duhej të zgjidhet paraprakisht me privatizimin apo përzgjedhjes së modalitetit të privatizimit të tyre në mënyrë që ato të kthehen në Buxhetin e Kosovës.

Konkluzione

Privatizimi në Kosovë ka një histori të vështirë. Rezultatet nga privatizimi i deritashëm i ndërmarrjeve shoqërore tregojnë se privatizimi me gjithë barrierat dhe vështirësitë e natyrave të ndryshme nëpër të cilat ka kaluar, ka funksionuar dhe se ai ka qenë mjaft ambicioz. Në opinionin publik, ky proces është karakterizuar me bllokim të mjeteve nga privatizimi, pak investitorë, shumë vonesa, çmime të lira, zvogëlim të numrit të punëtorëve, mospërmblidhje të premtimeve të blerësve, vonesa të shpërndarjes së 20-përqindëshit të punëtorëve, e shumë probleme të tjera.

Çështja e bllokimit të mjeteve nga privatizimi është një çështje që rregullisht kritikohet ashpër nga opinioni publik, e që është e drejtë shikuar nga prizmi ekonomik. Mirëpo, kjo është një çështje që rregullohet me ligj dhe çdo koment që bie ndesh me normat ligjore është i pabazë. Pjesa e 20% është për t'u ndarë për punëtorët, ndërsa 80% në parim mbahet në mirëbesim nga agjencia për të kënaqur kërkesat eventuale të kreditorëve potencial të ndërmarrjes përkatëse shoqërore, e të cilat do duhej të realizoheshin gjatë procesit të likuidimit. Vetëm pasi të bëhet shlyerja ligjore e ndërmarrjes shoqërore, përkatësisht likuidimi i saj, një teprice eventuale mund t'i bartet qeverise respektivisht buxhetit të konsoliduar të Kosovës.

Sa i përket shpërndarjes së 20% punëtorëve legjitimë të ndërmarrjes, ka pasur vonesa të ndjeshme e në disa raste ato nuk janë zgjidhur fare. Është e natyrshme që oda e veçantë ndodh shpesh të përballet me padi / kërkesa / ankesa të numërta e posaçërisht për ndërmarrjet e mëdha të cilët kishin me qindra apo mijëra punëtorë të punësuar. Shqyrtimi i tyre bëhet një nga një dhe natyrisht se çështjet e tilla procedurale konsumojnë kohë. Një rekomandim logjik për të shuar pakënaqësinë e sindikatës dhe revoltën e drejtë të punëtorëve, do të ishte që të gjithë punëtorëve që gjenden në listën e aprovuar nga AKP-ja (shkalla e I-rë) t'u shpërndahen mjetet në kuotën prej 75%, përderisa lista nuk ratifikohet përfundimisht nga oda e veçantë e Gjykatës Supreme.

Sido që të jetë, ekziston një konsensus i përbashkët i të gjithë akterëve në procesin e privatizimit, institucioneve relevante, qeverisë së Kosovës, bashkësisë ndërkombëtare etj, se privatizimi është domosdoshmëri për Kosovën dhe ai duhet të përkrahët nga të gjithë. Sa më parë të përfundojë një proces i tillë i vështirë, aq më tepër do të krijohen kushtet për zhvillimin e një ekonomie të tregut për të cilën tashmë është përcaktuar shoqëria jonë. Është e vërtetë që efektet pozitive të privatizimit ndikojnë në ekonominë kombëtare, mirëpo privatizimi nuk është gjithçka. Ambienti i mjedisit, siguria, investimet nga jashtë, politika fiskale, kreditore, etj janë faktorë makroekonomik me peshë të pakontestueshme për zhvillimin ekonomik, e që në rastin tonë nuk po tregojnë rezultate mbresëlënëse. Këta faktorë janë të lidhur ngushtë njëri me tjetrin, prandaj duhet të aplikohen masa uniforme për të siguruar një klimë atraktive dhe të shëndoshë për zhvillim e biznesit.

Një sfidë esenciale për qeverinë e Kosovës, padyshim se mbetet privatizimi i ndërmarrjeve publike. Modeli i privatizimit të tyre duhet të përzgjidhet me kujdesin më të madh për arsye se disa nga këto ndërmarrje kanë rëndësi të veçantë strategjike në zhvillimin ekonomik të vendit.

Qeveria e Republikës së Kosovës do të ishte e udhës që së pari t'i privatizojë ato ndërmarrje publike që janë duke e ngarkuar buxhetin e shtetit siç janë: KEK-u, Hekurudhat e Kosovës dhe Termokos-in, e jo ato që operojnë me sukses dhe i kontribuojnë buxhetin të Kosovës siç ishte rasti i Aeroportit të Prishtinës. Me rastin e privatizimit të KEK-ut duhet të kihet kujdes që së pari të privatizohet rrjeti shpërndarës e më vonë pjesa e prodhimit.

Qeveria nuk ka një politikë funksionale sa i përket përdorimit të fondeve nga privatizimi i NP-ve. Aspekte kyçe të kësaj çështjeje duhet të debatohen në Kuvend, në mesin e akademikëve dhe të shoqërisë civile. Pasi që këto korporata janë për të shërbyer për interesin publik në përgjithësi, për gjeneratat aktuale dhe ato të ardhshmet, konsiderohet se një pjesë e madhe e këtyre fondeve, pas shlyerjes së kostos së transaksionit, do të duhej të përdoret për investime publike në infrastrukturë, arsim dhe shëndetësi, grante për financimin e sektorëve deficitare ekonomike, etj.

Referencat

1. Andria Gams, "Osnovi Stvarnog Prava", 1978;
2. Aliu N, "Transformi i pronës", 2006
3. Buletini Ekonomik, qershor 2007;
4. Fetahu Adil, "Transformimi dhe Privatizimi i pronës shoqërore në Kosovë", Prishtinë, 2002
5. Jovan Đ, 1965, në Grahovac B, "Restrukturiranje i privatizacija javnog preduzeća", 2001
6. Management Information System (MIS), AKP, November, 2009;
7. Muharremi R, "Administrimi dhe Qeverisja ne Kosovë, 2005,
8. Pasqyra e përgjithshme a pakos së Ahtisarit, 2007;
9. Politikat Operacionale të AKM-së, Nëntor 2006;

10. Raporti i punës AKP, 2009
11. Raporti i OSBE-së, Privatizimi në Kosovë, Maj 2008;
12. Rregullorja e UNMIK-ut nr., 2002/12; Rregullorja e UNMIK-ut nr., 2005/18;
13. Riinvest, “Dilema dhe ngecje në rrugën e shpejtë, Privatizimi i ndërmarrjeve publike në Kosovë”, 2009
14. Selmanaj Selman, “Globalizimi dhe Tranzicioni – dilemat dhe sfidat”, 2006;
15. Statistikat e Tregtisë së Jashtme tetor 2008, Enti Statistikor i Kosovës;
16. Web Faqet: <http://www.ear.eu>; <http://www.pak-ks.org>;